

"PRISHTINA ENERGJETIKE"

NEWBORN

Projekti "P3-P5 Dalja 1"

"P3-P5 Dalja 1" është projekt në kuadër të megaprojektit investiv në rajonin e Prishtinës.

Plani investues i KEDS në Prishtinë përfshin rritjen e kapaciteteve të linjave ekzistuese nga 10 kV në 20 kV, krijimin e linjave alternative, futjen nën tokë të 90% të rrjetit të tensionit të mesëm, zëvendësimin e 50% të linjave të tensionit të ulët. Nga këto investime do të përfitojnë direkt 90 mijë konsumatorë.

Të dhëna specifike për projektin: Hapja e kanaleve të reja në shtrirje prej 1.8km. Do të përfshihen 18 transformatorë, vendosja e 12 km kablllo të reja të tensionit të mesëm.

Përfitues nga projekti "P3-P5 Dalja 1": 3,652 konsumatorë

Lokacionet ku do të punohet: Rr. Metush Krasniqi, Rr. Ismail Qemali, Rr. Ismet Krasniqi dhe Rr. Rugova.

Periudha e zhvillimit të projektit: 2020 – 2021

Përfundimi i projektit: Korrik 2021

Gjatë zhvillimit të punimeve konsumatorët do të informohen paraprakisht 24-48 orë përmes uebfaqes, rrjeteve sociale dhe aplikacionit eKesco.

